



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD**

---

**GJS-2024-005**

**Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës** – Fejzullah Rexhepi, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga P.B., kundër Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren – Sh.E., më datë 29.04.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET SI E PABAZUAR**, ankesa e nga P.B., kundër Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren – Sh.E..

**A r s y e t i m**

Gjykata Supreme, përmes Zyrës së Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më 02.04.2024, konform nenit 9 par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka pranuar ankesën e palës P.B., e parashtruar kundër kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren – Sh.E., si Autoritet Kompetent, sa i përket pretendimeve të shkeljeve disiplinore të Kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit (neni 9 par.1 nënparagrafi 1.2 i Ligjit të lartcekur).

Në ankesë, parashtruesi ka theksuar se më datë 30 nëntor ka pasur takim të caktuar me Kryetaren e gjykatës, me qëllim të parashtrimin të kërkesave të tij por që Kryetarja nuk e kishte pranuar në takim dhe se kishte thirrur Policinë e Shtetit me qëllim të largimit të tij. Tutje, parashtruesi ka paraqitur pretendimet e tij se ai është dënuar për marrje ryshfeti nga katër persona lidhur me patentë shoferët, ku për njërin prej tyre për periudhën e qershorit 2011, derisa pretendon se gjatë asaj kohe ai veçse ishte në vuajtje të dënimit.

Me qëllim të vërtetimit të bazës së arsyeshme siç kërkohet me ligj, të pretendimeve të lartcekura si autoritet kompetent kam kërkuar nga kryetarja që të deklarohet lidhur me këtë rast ku dhe kam pranuar deklaratën e të njëjtës.

Kryetarja e gjykatës në deklaratën e saj në mënyrë kronologjike ka shpjeguar rrjedhën e rastit duke theksuar në deklaratën e saj se, në Gjykatën e Prizrenit ndaj ankuesit është zhvilluar procedure penale, ku me aktgjykimin P.nr.206/2015 date 07.12.2016, është shpallur fajtor dhe dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 muaj, dhe ky aktgjykim ka marrë formë të prerë më 15.09.2017. Tutje në deklaratë e saj thuhet se i ka dhënë përgjigje ankuesit në të gjitha takimet e organizuara, të cilat ia ka bashkëngjitur procesverbalet e takimeve kësaj deklarate.

Lidhur me pretendimin e palës, se nuk e ka pranuar në takim dhe se ka ftuar Policinë e Shtetit që të njëjtin ta largoj nga ambientet e gjykatës, në deklaratë thuhet se kjo ka ndodhur për faktin se i njëjti kishte sulmuar sigurimin e gjykatës si dhe kishte tentuar me dhunë të shkoj në zyrën e Kryetares. Derisa në takimin e fundit që ishte më datë 28.07.2023, i njëjti kishte shkaktuar probleme, ka bërtitur, ka ofenduar gjyqtarët dhe kryetaren, nisur nga këto në deklaratën e kryetares thuhet se, kam vendosur se kërkesat e tij do të pranohen vetëm me shkrim dhe jo personalisht pasi që i njëjti nuk ka respekt për gjykatën.

Kryetarja në deklaratën e saj gjithashtu ka theksuar edhe raste të tjera kur ankuesi është dashur të largohet nga hapësirat e gjykatës përmes intervenimit të Policisë, për shkak sjelljeve të tij të cilat kishin shqetësuar edhe palë të tjera të cilat ishin prezentë.

Kryetari i Gjykatës Supreme pas shqyrtimit të pretendimeve në ankesës vlerësoi se:

- Ankesa është e pabazuar.

Si autoritet kompetent, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura vlerësoj se ankesa ne rastin konkret është dukshëm joserioze. Ngase, e njëjta kryesisht ka të bëjë me procesin e vendimmarrjes se gjyqtareve të Gjykatës Themelore ne Prizren, se pari, ndaj procedurës penale që është zhvilluar ndaj tij qe ka rezultuar me aktgjykim me te cilin është shpall fajtor dhe që ka marrë forme te prerë. Në këtë drejtim si autoritet kompetent nuk është në kompetencën time të vlerësoj aktgjykimet dhe aktvendimet e formës së prerë.

Përveç kësaj, bazuar në deklaratën si dhe shkresave të tjera të lëndës del se, kryetarja i është përgjigjur të gjitha kërkesave të tij, dhe se e njëjta pas sjelljeve të cilat kanë shpërfaqur mos respekt ndaj gjykatës, është detyruar të kërkoj largimin e tij nga hapësirat e gjykatës me intervenimin e Policisë së Shtetit. Theksoj se, të gjitha palët janë të obliguara të tregojnë respekt në ambientet e gjykatave, duke manifestuar një sjellje të përshtatshme dhe të dinjitetshme para autoriteteve gjyqësore.

Bazuar në këto fakte, si autoritet kompetent vlerësoj se nga ankesa e paraqitur nuk rezulton asnjë dyshim se kryetarja e Gjykatës Themelore ne Prizren ka kryer shkelje disiplinore.

Andaj, për shkak se në parashtresën e palës, nuk potencohet ndonjë shkelje konkrete e supozuar disiplinore, të cilat janë të parapara në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Fejzullah Rexhepi  
Kryetar i Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës,
2. Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren,

3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.